

TERMAT E REFERENCËS

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- 1) Shtimi i numrit serial të faturës në sistem (ku përfshihet oracle db, procedura internal si dhe aplikim)
 - a. konsiston në ndryshimin e modelit të faturës tatimore të shitjes sipas përcaktimit të UKT dhe DPT
 - b. konsiston në ruajtjen dhe integritetin e faturës tatimore si titull ekzekutiv
 - c. konsiston në përshtatjen e sistemit dhe moduleve të tij që të reflektojë këtë ndryshim në të gjithë format e tij si dhe të ruajë sistorikun e saj.
- 2) Shtimin e kapacitetit të pagesave online si dhe lidhjeve të bankave të tjera tregtare
 - a. konsiston në zhvillimin e modulit të pagesave dhe ofrimin e këtij shërbimi online për të gjithë subjektet e interesuara në formën e shkëmbimit të të dhënave me sftp, web ose direct database access
 - b. ky shërbim do të përfshijë metodat: i. kryej pagesë, ii. konsulto faturën korente të abonentit, iii. konsulto debinë e abonentit, etj sipas përcaktimeve të Departamentit të Financës dhe Shitjes
- 3) Saktësimin e formës së regjistrimit të vlerës së ujë matësit si dhe kolaudimit në faturën tatimore (ndjekje e saktë e pagesave)
 - a. konsiston në përmirësimin e formës së regjistrimit të faturës ku të mundësohet regjistrimi i vlerës së ujëmatësit dhe shfaqjen e saj saktkësisht në faturë
- 4) Sistemin dhe zgjidhjen e problematikës së kamatave jo si regjistrim por si funksion në sistem
 - a. konsiston në përmirësimin e sistemit ku të mundësohet që kamata të jetë funksion dhe jo vlerë e përlogaritur cdo ditë
 - b. konsiston në përmirësimin e formës së regjistrimit të arkëtimeve që vijnë me vonesë dhe llogaritjen e kamatës në atë ditë
- 5) Krijimi i nje Web Sercive të ri me qëllim eliminimin e problematikave egzistuese, dokumentimin e tij si dhe shtimin e kapaciteteve apo shërbimeve online
 - a. ky shërbim do të përfshijë metodat: i. kryej pagesë, ii. konsulto faturën korente të abonentit, iii. konsulto debinë e abonentit, etj sipas përcaktimeve të Departamentit të Financës dhe Shitjes
- 6) Formë e re në aplikim për administrimin e listës së bashkisë në lidhje me aplikimin e tarifës së pastrimit (përfshirë nga tarifa e pastrimit si dhe vendosje)
 - a. konsiston në zhvillimin e një forme të vecantë për të administruar listat që vijnë nga bashkia për përfshirjen e disa abonentëve për taksat e saj apo përfshirjen e tyre
- 7) Zhvillimin e mëtejshëm të formës së hapjes dhe administrimit të kontratave të reja
 - a. konsiston në zhvillimin e disa moduleve të vecante per administrimin e kontratave, si: hapje kontrate, regjistrim matesi dhe të dhënave të tij, regjistrim tarife, regjistrim adrese, regjistrim statusi kontrate, regjistrim te dhënash shtesë, etj sipas kërkesave të Departamentit të Shitjes
 - b. ruajtjen e informacionit të kartelës apo procedurave të ndjekura për abonentin në formë elektronike të skanuara (format pdf, imazh, etj)

- 8) Zhvillimin e mëtejshëm dhe saktësimin e formës së rregjistrimit (montim/demontimit) të matësave
 - a. konsiston në zhvillimin e mëtejshëm si dhe saktësimin e modulit online për montim / demontim matësi
 - b. moduli duhet të mundësojë ruajtjen e koordinatave të punonjësit të shoqërisë në momentin e montim/demontimit
 - c. moduli duhet të mundësojë ruajtjen e të dhënave të plota të matësit tv demontuar si dhe atij të montuar duke përfshirë edhe fotografitë e matësave si dhe objektit
 - d. moduli duhet të ofrojë mundësinë e konsultimit të informacionit dhe printimit të proces verbaleve respektive
- 9) Formë e re në aplikim për azhornimin e kompensimeve respektive, rregjistrimin e tyre në faturë dhe konfirmimin e saj
 - a. konsiston në përmirësimin e sistemit duke krijuar një modul të vecantë për shitjen ku ajo të ketë mundësinë e administrimit të kompensimeve si dhe saktësimin dhe kalimin e tyre në faturat e abonentëve
- 10) Formë e re në aplikim për rregjistrimin e faturave që nuk janë me matje sipas njësive
 - a. konsiston në përmirësimin e formës ekzistuese për administrimin dhe krijimin e faturave për abonentët jo me matje
 - b. kjo formë do të përdoret nga Departamenti i Shitjes në vartësi të mbylljes së faturimit sipas zonave dhe nënzonave të saj
- 11) Ndryshimi i faturës tatimore në mënyrë që të mos krijohet gjithnjë skedar në server në mënyrë që të rritet performanca e pajisjeve dhe sistemit
 - a. konsiston në ruajtjen e hapësirës në server si dhe rritjen e shpejtësisë së procesimit dhe shfaqjes së faturës për printim dhe konsultim
 - b. fatura të krijohet në klient dhe jo server
- 12) Formë të re në aplikim për saktësimin dhe azhornimin e faturave duke referuar saktë informacionin shkresor të praktikave (+ skanim dhe ngarkim në sistem)
 - a. konsiston në zhvillimin e një praktike të saktë në lidhje me faturat saktësuese apo zbritëse
 - b. procedura duhet të përfshijë krijimin e një fature zbritëse duke mundësuar ngarkimin e të gjithë të dhënave të praktikës së skanuar
- 13) Formë e re në aplikim për hapjen dhe mbylljen e muajit të faturimit si dhe mbylljen e librit të shitjeve
- 14) Zhvillimin e sistemit për taksën e apartamentit si dhe azhornimin e bazës së të dhënave si dhe procedurave respektive për përfshirjen e kësaj takse
 - a. konsiston në zhvillimin e formave respektive si dhe azhornimin e të gjithë sistemit për të pranuar në formë dinamike të gjithë taksat dhe tarifat që Bashkia mundet t'i caktojë që të mblidhen nga shoqëria
- 15) Shtimin e raporteve për administrimin e takses së apartamentit (sa faturuar dhe sa arkëtuar)
 - a. azhornimi i raporteve si dhe shtimin e raporteve respektive sipas kërkesave të shitjes si dhe bashkisë me qëllim evidentimin e faturimit të taksave dhe tarifave të bashkisë si dhe arkëtimit të tyre
- 16) Saktësimi i modulit të Bashkisë për raportimin e taksave të faturuara dhe arkëtuara periodikisht (ditore, mujore, vjetore)
 - a. sistemi ka të përfshirë disa module ku njëri ndër to është edhe ai i vënë në dispozicion të bashkisë me qëllim konsultimin online të informacionit mbi faturimin, arkëtimin dhe kompensimin e taksave dhe tarifave të saj
 - b. azhornimi konsiston në shtimin dhe plotësimin e raporteve respektive me qëllim reflektimin e situatës financiare

- 17) Formë e re në modulën e faturës online për abonentët në mënyrë që të rimarrin fjalëkalimin e tyre
 - a. konsiston në përmirësimin e modulit të konsultimit të faturës online si në informacion, design ashtu edhe ofrimin e mundësisë që abonenti ta administrojë vetë fjalëkalimin e tij
 - b. zhvillimin e mëtejshëm të modulit të ankesë / kërkesave online
 - c. zhvillimin e mëtejshëm të lidhjes së kontratave për bizneset me qëllim përdorimin e vetëm një fjalëkalimi për bizneset me shumë kontrata
- 18) Zhvillimin dhe saktësimin e modulit të ankesë/kërkesave me delegimin e tyre si dhe përgjigjeve duke monitoruar edhe afatet e tyre
 - a. konsiston në zhvillimin e mëtejshëm të modulit të ankes/kërkesave, lidhjes së tij me atë online
 - b. zhvillimin e shkëmbimit të informacionit nëpërmjet email me abonentin (dërgimin e statusit tek abonenti si dhe përfshirjen e ankesë/kërkesës në modulën online)
- 19) Shtimin dhe saktësimin e raporteve specifike sipas kërkesës së departamentit të shitjes, arkëtimit dhe financës
 - a. raporte faturimi sipas zërave, arkëtimi sipas zërave si dhe debie sipas zërave
 - b. raporte për ndjekje dhe analizim të faurimit apo arkëtimit
 - c. lista të ndryshme për abonentin, debinë e tij, faturën korente
 - d. lista debie aktuale apo në një datë të caktuar
- 20) Shtimin e raporteve të auditit në aplikim dhe saktësimin e auditimit të sistemit
 - a. konsiston në shtimin dhe përmirësimin e sistemit të auditit si dhe raporteve të cilat do të ndihmojnë në monitorimin e punonjësve apo abonentëve
- 21) Saktësimin dhe ruajtjen e situacioneve mujore të faturimit dhe arkëtimit me baza mujore
 - a. konsiston në krijimin e listave fikse të cilat nuk ndryshojnë dhe ruajnë të pa prekur faturimin, arkëtimin dhe debinë e abonentit në baza mujore
- 22) Shtimin e modulit të raportimit për Drejtorin e Përgjithshëm
 - a. konsiston në shtimin e raportimeve për planet e punës në baza javore dhe mujore, raportimin nga shitja (faturim, arkëtim, debi), raportimin nga teknika (projekteve dhe statuseve të tyre), raportimin nga media të aktiviteteve si dhe raportimin e mirëmbajtjes (defekteve si dhe statuset e tyre)
 - b. monitorimin e raportimeve, afateve dhe statuset e tyre sipas prioriteteve
 - c. monitorimin dhe prezantimin e tyre në mbledhjet javore të shoqërisë
 - d. caktimin e prioriteteve si dhe caktimin e saktë të detyrave javore dhe nxjerrjen e përgjegjësisë
 - e. krijimin e raporteve dhe statistikave respektive sipas raportimeve
- 23) Shërbim mirëmbajtje dhe zhvillime të tjera sipas kërkesës së UKT, për 1 vit
 - a. konsiston në mirëmbajtjen e sistemit të faturimit me të gjithë modulet apo nën modulet e tij
 - b. kompania duhet të alokojë sa herë të kërkohet një ose më shumë punonjës që të punojnë me stafin e IT si dhe në ambjettet e UKT. Koha minimale e angazhimit pranë UKT do të jetë 10 ditë në muaj, grafik i cili vendoset nga UKT.

Vendi i kryerjes së shërbimeve:UKT sh.a

